

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Tirana duhet t'i nderojë", Erion Veliaj propozon që ish-liderët e UÇK-së të shpallen "Qytetarë Nderi"
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/kryebashkiaku-veliaj-proponon-qe-lideret-e-uck-se-te-shpallen-qytetare-nderi-te-tiranes/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:12:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:10:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d9bc67e585dfef88fbadfd41d556128234816659cd77e0b6b8afb4b6b9f5d71b
TEKSTI	5f4deb4a73b2381cd07b7dd542c609f8ec5b8778fd27e62f78600457a6e3aff7
PAMJA	4a345386ea5f1cec316ba04a7d9865ba1e9b235df38bb63807e8ed7c8c907ece

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b5c5a34bd46a18cbb6e1199ce9b8c5fa22725a6042cbfd03fd8e43f5699d748b
E MËPARSHMJA	2341de0b16d140db1e7cf4ff6b0def417a2fdd444df8aa98549d236e5bd6aaee
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b5c5a34bd46a18cbb6e1199ce9b8c5fa22725a6042cbfd03fd8e43f5699d748b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

"Tirana duhet t'i nderojë", Erion Veliaj propozon që ish-liderët e UÇK-së të shpallen "Qytetarë Nderi"

AKTUALITET KRYESORE E SHTUNË, 19 SHTATOR 2026 14:10



Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj ka propozuar shpalljen "Qytetarë Nderi" të Tiranës për Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, në shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi për kontributin e tyre historik në lirinë e Kosovës. Veliaj u ka bërë thirrje edhe bashkive të tjera në Shqipëri të ndërmarrin të njëjtën nismë. Propozimi vjen pasi ish-liderët e UÇK u dënuan me 81 vite burg nga Gjykata Speciale e Hagës.

Deklarata e plotë



Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë, të dashur qytetarë të Tiranës, të dashur shqiptarë kudo që jeni, Po bëj 19 muaj në izolim. Nëntëmbëdhjetë muaj pa mundësinë reale për të ushtruar mandatinkushtetues që më kanë besuar qytetarët e Tiranës me një rekord historik votash.

Vetëm pak ditë më parë u mor një tjetër vendim gjyqësor që ishte një grusht institucional ndaj demokracisë vendore. Natyrshëm, mund të prisnit që sot t'ju flisja për këtë. Por ka momente në jetën e një njeriu kur drama e tij personale bëhet e vogël, përpara një çështjeje kombëtare. Vendimi i dhënë në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit më ka tronditur thellë. Sigurisht procesi juridik ka rrugën e vet dhe drejtësia duhet të ndjekë deri në fund procedurat dhe standardet e saj. Por ne shqiptarët kemi edhe përgjegjësinë për të kujtuar.

Për të kujtuar si liria e Kosovës erdhi pas dekadash represioni, dhimbjeje dhe rezistence, pas familjesh të dëbuara nga shtëpitë e tyre, jetësh të humbura dhe sakrificash të jashtëzakonshme, pas vendimit të një populli për të mos pranuar më që fati i tij të përcaktohej nga të tjerët. Në atë histori, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka vendin e saj të lavdishëm, sikurse ushtarët e saj Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Ata janë katër burra që historia i vendosi në një prej kapitujve më të vështirë dhe më vendimtarë të Kosovës. Kam jetuar dhe punuar në Kosovë, e njoh nga afër Hashimin ...

Ndaj sot dua që Tirana të flasë. Tirana nuk është vetëm kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, por kryeqendra e shqiptarisë. Për këtë arsye, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, do t'i propozoj Këshillit Bashkiak që: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi të shpallen Qytetarë Nderi të Tiranës.

LAJMET KRYESORE



"Tirana duhet t'i nderojë", Erion Veliaj propozon që ish-liderët e UÇK-së të shpallen "Qytetarë Nderi"



Nga fjalimi në OKB tek takimet me diasporën, Rama me një axhendë të ngjeshur në Amerikë



Ambasada e Amerikës: Hap gjigant për Shqipërinë, nënshkrimi i marrëveshjeve Artemis në selinë e NASA-s



Burri vret bashkëshorten në sy të nipit 14-vjeçar, arratiset nga vëndngjarja. Reagon edhe Policia



4 ndeshje në Nations League, Maran grumbullon 29 lojtarë. Del lista zyrtare

TË PËRZGJEDHURA



Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"



Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: "Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar..."



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve

MË TË LEXUARAT

Sigurisht jo për ta zëvendësuar drejtësinë me politikën. Jo për t'i treguar një gjykatë se çfarë duhet të vendosë. Por për të ushtruar të drejtën e qytetit tonë për të shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e vet për kontributin e tyre historik në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe shtetësisë.

Tirana fatkeqësisht nuk mund t'ua japë dot lirinë. Por Tirana duhet t'i nderojë ata. E nga Tirana dua t'u drejtohem edhe kryetarëve dhe këshillave bashkiakë të qyteteve të tjera shqiptare, të nderojnë si Tirana. Pasi këta katër burra nuk janë pjesë vetëm e historisë së një qyteti. Ata janë pjesë e historisë së Kosovës dhe përmes saj, e historisë sonë shqiptare. Le t'u tregojmë familjeve të tyre se nuk janë vetëm. Le t'u tregojmë shqiptarëve të Kosovës se Shqipëria nuk e harron Kosovën. Le t'u tregojmë brezave që vijnë se një shoqëri mund të respektojë drejtësinë dhe njëkohësisht, të ruajë kujtesën e vet historike.

Prandaj sot, nga vendi ku ndodhem, dua t'u them Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit: Procesi juaj juridik do të vazhdojë. Drejtësia do të ndjekë rrugën e saj. Por edhe kujtesa jonë do të ndjekë të vetën. Nuk do ta harrojmë Kosovën e represionit dhe të dëbimeve. Nuk do t'i harrojmë ata që humbën jetën. Nuk do t'i harrojmë familjet që sakrifikuan gjithçka dhe nuk do ta harrojmë kontributin e atyre që morën përgjegjësi në luftë dhe më pas në ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Unë mund të jem sot pas një dere të mbyllur, por pikërisht këtu kam kuptuar edhe më mirë diçka shumë të thjeshtë: liria është një nga ato fjalë, peshën e plotë të së cilës e kupton edhe më fort kur të mungon. Ndoshta prandaj sot e ndiej Kosovën edhe më afër. Sepse historia e saj na kujton se liria nuk bëhet e përhershme vetëm sepse është fituar një herë. Ajo ruhet. Mbrohët. Kujtohet. Nderohet.

Për ata që nuk arritën ta shinin ditën e saj. Për familjet që paguan çmimin e saj. Për të gjithë ata që luftuan dhe punuan për të. Për Kosovën. Për lirinë. Për kujtesën tonë kombëtare. Ata duhet dhe do jenë nderi i kryeqytetit tonë, Tiranës.

Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë së Tiranës

ETIKETA VELIAJ

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Fluks në Morinë, shqiptarët e Kosovës vijnë udhëtimet edhe pas përf...

Ministri Jaupaj pjesë e takimit ministerial për Agjendën e Gjellbër pë...

Kandidatët për kryetarë bashkie, Berisha ndryshon formulën e PD-së



Maran nuk e grumbulloi, Jasir Asani me postime thumbuese: Historia nu...



Aksione pastrimi përgjatë vijës bregdetare në disa qytete



G*diti për vd*kje bashkëshorten, burri vetëdorëzohet në polici. Dalin...

LAJMET E FUNDIT



IKMT vijon aksionin në Shkodër, lirohen hapësirat pranë shkollës "Mati Logoreci"

[22 MINUTA MË PARË](#)



Sina dhe Kerjota, risitë e Maran te Kombëtarja shqiptare

[33 MINUTA MË PARË](#)



Fluks në Morinë, shqiptarët e Kosovës vijnë udhëtimet edhe pas përfundimit të sezonit veror

41 MINUTA MË PARË



Varret masive në Zubin Potok, Albin Kurti: ADN-ja konfirmon identitetin e 3 prej viktimave

53 MINUTA MË PARË



Ministri Nufi: 26 efektivë të FA trajnim me fokus terminologjinë tekniko-ushtarake

1 ORË E 0 MINUTA MË PARË

Ministri Jaupaj pjesë e takimit ministerial për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor

1 ORË E 7 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONE

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frashëri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.